



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1588 / Prot
1

Tiranë, më 6.3 2023

UDHËZIM

Nr. 7 datë 6.3 2023

PËR

**NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 15.02.2023 “PËR
PËRCAKTIMIN E DIPLOMAVE UNIVERSITARE TË NJËVLERSHME,
TË NGJASHME OSE TË PËRAFËRTA ME FUSHËN/LËNDËT
E MËSIMDHËNIES NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR DHE KRITERET PËR
HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË FORMIMIT
TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4 të nenit 57 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Kreu III i udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2023 “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përfaqësuara me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike”, ndryshon si më poshtë:

“Kreu III

Dispozita të fundit

1. Për t’u regjistruar në programin përkatës të studimit të formimit të vazhduar në fushën e psiko-pedagogjisë, kandidatët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar për ciklin e parë të studimeve, të vendosur për pranimet në programet e ciklit të parë të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë në fushën e mësuesisë, i cili ka qenë në fuqi në vitin akademik në të cilin këta kandidatë kanë filluar studimet e ciklit të parë “Bachelor”, si dhe për gjithë kandidatët e tjerë që nuk kanë ndjekur këtë kategori programesh studimi të ciklit të parë, sipas fushave të përcaktuara në aneksin nr. 1, por duan të ndjekin programin e formimit të vazhduar.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale Arsimore Parauniversitare, Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitare dhe institucionet e arsimit të lartë.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTËR

EVIS KUSHI

